



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVO  
REPUBLIKA KOSOVA  
KOMUNA E PEJËS MUNICIPALITY OF PEJA OPŠTINA PEĆ



---

**KUVENDI I KOMUNËS SË PEJËS**

**Komiteti për Komunitete**

**Data: 19.06.2026**

**Për: Anëtarët e Komitetit për Komunitete – KpK**

**FTESË**

Të nderuar anëtar/e,

Ju ftojme që të merrni pjesë në mbledhjen e IV të Komitetit për Komunitete për vitin 2026. Mbledhja do të mbahet me dt. 19.06.2026 (e premte), ora: 10:00, në sallën e Komitetit për Politikë dhe Financa.

*Vërejtje: Komiteti për Komunitete mbanë të drejtën për ta aplikuar nenin 45. paragrafin 3. të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nëse kjo gjë shihet e nevojshme.*

**RENDI I DITËS**

1. Aprovimi i rendit të ditës.
2. Shqyrtimi dhe miratimi i Procesverbalit të Komitetit për Komunitete dt. 21.05.2026.
3. Raporti i Zyrës për Kthim dhe Komunitete.
4. Raporti i Drejtorisë për Financa lidhur me përgatitjen e buxhetit për komunitetet joshumicë për vitin 2027.

Kryesuesi i Komitetit për Komunitete  
Muamel Dupljak



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVO  
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E PEJËS    MUNICIPALITY OF PEJA    OPŠTINA PEĆ

---

## KOMITETI PËR KOMUNITETE

### PROCESVERBAL

Mbledhja e III -te e Komitetit për Komunitete u mbajt më 21.05.2026, në ora 10:00, në sallën e Komitetit për Politikë dhe Financa.

#### Të pranishëm:

1. Dafina Draga (LDK) – Anëtare e Kuvendit
2. Vjendita Kelmendi-Gërkoci (AAK) – Anëtare e Kuvendit
3. Mubera Belegu (LVV) – Anëtar i Kuvendit
4. Muamel Dubljak (BSK) – Anëtar i Kuvendit
5. Mirsad Berisha (PLE) – Anëtar i Kuvendit
6. Miloš Dimitrijević (SERB) – Përfaqësues i komunitetit Serb
7. Omer Dacić – Përfaqësues i komunitetit Boshnjak
8. Edmir Delija – Përfaqësues i komunitetit Egjiptian
9. Sofije Toska – Përfaqësuese e komunitetit Rom

Të pranishme ishin edhe znj. Valbone Belegu Osce dhe znj. Ajshe Qela UNMIK, të cilat i falënderojmë për pjesëmarrjen.

#### Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Raporti i Zyrës për Komunitete dhe Kthim;
3. Raporti i Policisë së Kosovës;
4. Informatë nga DKA;
5. Të ndryshme

**Për procesmbajtës të takimit u zgjodh z. Admir Delija.**

**Të pranishëm ishin: z. Sabahudin Ciriković, Shef i Zyrës për Komunitete dhe Kthim, z. Dervish Haxhij Zëvendëskomandant i Policisë së Kosovës, anëtarët e Komitetit për Komunitete dhe përfaqësues të institucioneve komunale.**

**Pas hapjes së mbledhjes u miratua rendi i ditës.**

**Z. Sabahudin Ciriković** informoi të pranishmit lidhur me procesin e kthimit të personave të riatdhesuar. Personat që kthehen nga shtetet e ish-Jugosllavisë, qoftë në mënyrë vullnetare apo të imponuar, duhet të paraqiten në Zyrën për Komunitete dhe Kthim për t'u përfshirë në programet mbështetëse.

U raportua se janë mbajtur tri takime dhe janë aprovuar 12 raste. Rastet e tjera kërkojnë vizita shtesë në terren dhe koordinim me Ministrinë për Komunitete dhe Kthim. U diskutua një rast nga komuniteti egjiptian në Istog dhe u kërkua informimi i komuniteteve për thirrjet publike për ndërtimin e shtëpive. Plani i veprimit është dërguar në ministri.

U diskutuan edhe dy familje të kthyera në Istog, si dhe vështirësitë e personave të riatdhesuar të cilëve u premtohet pritje institucionale në aeroport, gjë që jo gjithmonë realizohet.

**Më pas u miratua Draft-Planprogrami për vitin 2026.**

**Znj. Davina Draga** ngriti çështjen e personave të peregjistruar në regjistrat civilë dhe rastet e familjeve me mungesë dokumentacioni. U diskutua rasti i një shtetaseje nga Bosnja me dokumente të skaduar dhe mundësitë për zgjidhjen e procedurave administrative.

## **RAPORTI I POLICISË SË KOSOVËS**

**Z. Dervish Haxhij - Zëvendëskomandanti Rajonal i Policisë në Pejë.** prezantoi raportin e sigurisë:

- 536 incidente të regjistruara;
- 458 vepra penale;
- 1 rast tentim-vrasjeje;
- 22 vepra penale lidhur me narkotikët;
- 224 raste që ndërlidhen me armët;
- 11 incidente në shkolla;
- 70 aksidente me lëndime;
- 2 aksidente me fatalitet;
- 51 gjoba për motoçikleta;
- 1 protestë;
- 199 asistime gjyqësore;
- 3,650 gjoba për kundërvajtje.

Në komunë funksionojnë 7 Këshilla Lokale për Siguri Publike. Janë realizuar 4 projekte nga policia e lagjes, 77 takime me këshillat lokale, 25 takime me OJQ, 100 vizita në fshatra, 33 vizita në komunitete joshumicë dhe 30 aktivitete me komunitetet.

Janë mbajtur 125 ligjërata në 26 shkolla me pjesëmarrjen e 2,230 nxënësve dhe janë ndaluar 124 persona në mbajtje.

Asambleistja Vjendita Kelmendi Gergoci pyeti lidhur me 11 incidentet në shkolla dhe nëse ato konsiderohen alarmante. Z. Haxhiaj sqaroi se nuk ka pasur armë të ftohta apo armë zjarri dhe se rastet kanë qenë kryesisht mosmarrëveshje verbale ndërmjet nxënësve. Ai theksoi rëndësinë e parandalimit dhe reagimit të hershëm.

## **INFORMATË NGA DREJTORIA KOMUNALE E ARSIMIT**

**Zyrtarja e Drejtorisë së Arsimit Shqipe Harbuzi Karagjyzi** ka paraqitur raportin si vijon,

U prezantuan informatat për përfundimin e vitit shkollor:

- 14 maj – maturantët;
- 5 qershor – klasat IX, X dhe XI;
- 19 qershor – parafillorët dhe klasat I-VIII.

Testi i Maturës mbahet më 20 qershor, ndërsa Testi i Arritshmërisë më 26 qershor në 8 qendra testimi.

Për komunitetin boshnjak është caktuar Qendra nr. 3 në SHFMU “Rifat Gjota”. Janë gjithsej 24 nxënës: 7 nga SHFMU “Xhemajl Kada”, 13 nga SHFMU “7 Shtatori” dhe 4 nga SHFMU “28 Nëntori”.

Për komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian janë paraparë 5 vende me kuotë në shkollat e mesme.

Asambleistja Vjendita Kelmendi Gergoci kërkoi që shkollat të pajisen me fotokopjues të rinj. U theksua se SHFMU “Xhemajl Kada” ka vetëm një fotokopjues të vjetruar, SHFMU “7 Shtatori” ka nevojë për pajisje të re, ndërsa në SHFMU “Skënderbeu” mungon fotokopjuesi.

**Pejë,**  
**21.05.2026**  
**Procesmbajtëse,**  
**Edmir Delija**